



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren — Prizren Belediyesi

Datë: 01/12/2025

Thirrje për Shfrytëzimin e Shtëpizave të Drurit

Qëllimi

Komuna e Prizrenit përmes organizimit “Dimri Kulturor”, hap thirrjen për përzgjedhjen e bizneseve që do të shfrytëzojnë shtëpizat e drurit në sheshin e Lidhjes gjatë festave të fundvitit. Bizneset e përzgjedhura do të ofrojnë produkte gastronomike dhe shërbime me tematikë dimërore dhe turistike.

Vendi dhe Orari i Punës

Hapja zyrtare e aktivitetit të shtëpizave dhe Festimeve të Fundvitit do të bëhet nga data **10 dhjetor 2025**, deri më **05 janar 2026**

Bizneset duhet të operojnë **çdo ditë nga 12:00h – 24:00h**.

Hapja pas orës 12:00h sjell **humbjen e të drejtës së shfrytëzimit të shtëpizës**.

Kriteret e Aplikimit dhe Operimit

Përzgjedhja e bizneseve do të bëhet nga komisioni i Komunës së Prizrenit.

Numri i shtëpizave është i kufizuar. Kriteret përcaktuese janë:

- Bizneset duhet të jenë të regjistruara në ATK, me aktivitet në Komunën e Prizrenit.
- Të dorëzojnë deklaratë nga ATK që nuk kanë obligime të papaguara.
- Të paraqesin menynë me çmime.
- Lejohen vetëm artikujt e miratuar në aplikim.
- Bizneseve të përzgjedhura do t'u lejohet një numër i caktuar i shankereve dhe burëve para shtëpizave.
- Të vendosin shporta mbeturinash dhe të mirëmbajnë pastërtinë.

Shënim: Lokacionet e shtëpizave caktohen nga Komuna e Prizrenit, sipas planifikimeve për gjithëpërfshirje.



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren — Prizren Belediyesi

Datë: 01/12/2025

Përparësitë në përzgjedhje

Përparësi do të kenë:

- Bizneset që promovojnë përdorimin e produkteve lokale/vendore.
- Bizneset që ofrojnë produkte ushqimore inovative dhe produkte me motive të stinës së dimrit.

Kritere Objektive për Përzgjedhje

- Produkte vendore/tradicionale.
- Brendim i rregullt dhe imazh profesional.
- Produkte inovative me motive festive.
- Përvojë në aktivitete turistike ose panaire.
- Koncept festiv i qartë dhe i realizueshëm.
- Qarkullim financiar stabil.

Kodi i Mirësjelljes dhe Obligimet Shtesë

Të gjitha bizneset janë të obliguara të tregojnë frymë bashkëpunimi të mirëfilltë. Ndalohet rreptësisht:

- Kryerja e veprave të paligjshme ose akteve të dhunshme brenda zonës.
- Abuzimi verbal ose fizik ndaj personave.
- Shitja e produkteve që nuk janë të parashikuara në aplikim.
- Mosmbajtja e pastërtisë brenda dhe rreth shtëpizës.
 - Dy ankesa të përsëritura për mos-pastrimin e hapësirës sjellin **shkëputjen e menjëhershme të marrëveshjes**.

Muzika dhe Performancat

Muzika dhe aktivitetet artistike organizohen vetëm nga Komuna duke respektuar pozicionet e kontratës.

Muzika apo performancat individuale të bizneseve janë **të ndaluara rreptësisht**.



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren — Prizren Belediyesi

Datë: 01/12/2025

Mënyra e Aplikimit

- Plotësoni aplikacionin e bashkangjitur.
- Dokumentet e domosdoshme:
 - Kopja e certifikatës së regjistrimit të biznesit me detaje (përfshirë veprimtarinë kryesore të biznesit)
 - Deklarata nga ATK.
 - Menuja me çmime.
 - Kopja e letërnjoftimit të aplikuesit.
- Aplikuesit që ofrojnë ushqim dhe/ose pije duhet të dorëzojnë menynë përkatëse me çmime.
- Lejohet vetëm një aplikim për një person juridik; aplikuesi duhet të jetë pronar biznesi.

Afati i Aplikimit:

01/12/2025 – 05/12/2025 (ditë e premte) nga ora **08:30 – 12:00** në objektin e Komunës së Prizrenit, tek sporteli i kërkesave.

Çdo aplikim duhet të protokollohet me emërtimin:

“Kërkesë për shfrytëzimin e Shtëpizave për Festat e Fundvitit”.

Më pas do të njoftoheni për datën e nënshkrimit të kontratës dhe procedurat e mëtejme.

Vërejtje:

Biznesi i cili pas shqyrtimit të aplikacioneve nga ana e Komisionit fiton të drejtën e shfrytëzimit të shtëpizës për të operuar, nuk ka të drejtë të nënkontraktojë ose të bëjë marrëveshje me ndonjë biznes tjetër për operim, në të kundërtën do t'i nderpritet kontrata.

Drejtoria për Turizëm dhe Zhvillim Ekonomik

Komuna e Prizrenit

U.D. Sherife Cengaj

